



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHEVE TË HUAJA**

PROJEKTI FITUES ME TITULL:

**“RËNDËSIA E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË
FORMIMIN AKADEMIK”**

**FINANCUAR NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT PËR
VITIN AKADEMIK 2022-2023**



Ekipi i projektit:

Prof. Asoc. Dr. Eglantina GISHTI (koordinatore)

Prof. Asoc. Dr. Alba FRASHËRI

Dr. Fjoralba DADO

Aktivitet mbi realizimin e punës në fazën e parë:

NGRITJA E INFRASTRUKTURËS KËRKIMORE-SHKENCORE




Në datën 14.02.2023, në mjediset e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, në praninë e Ministres së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit-MAS, Zj. Evis KUSHI dhe të Rektorit të UT-së, Prof. Dr. Artan HOXHA, Dekanes së FGJH-së, Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA, të personelit akademik dhe studentëve, u zhvillua ceremonia e përrurimit të 4 (katër) laboratorëve të mësimdhënies dhe të kërkimit, të realizuar me financimin e dy projekteve në kuadër të thirrjes së hapur për projekte nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, ku ben pjesë edhe projekti: “*Rëndësia e Inteligjencës Artificiale në Formimin Akademik*”.

Në fjalën e hapjes së kësaj ceremonie, Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA vuri theksin tek rëndësia e këtyre projekteve infrastrukturore në shërbim të zhvillimit të kapaciteteve të infrastrukturës akademike, didaktike dhe kërkimore, të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit duke mundësuar realizimin e hulumtimeve dhe punëve kërkimore me standarde të larta, impaktit të drejtpërdrejtë që do të kenë këto investime teknologjike në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, inovacionit pedagogjik në mësimdhënie, rrjetëzimit të kërkuesve shkencorë vendas e të huaj duke realizuar takime, tryeza apo konferenca të përbashkëta.

Rektori i Universitetit të Tiranës, Prof. Dr. Artan HOXHA shprehu falënderimet për punën e kryer nga FGJH si edhe mbështetjen e vazhdueshme për të përkrahur nismat e FGJH-së në drejtim të digjitalizimit dhe ndërkombëtarizimit të programeve studimore. ***Prof. Hoxha e vuri theksin tek rëndësia e diplomave të dyfishta ku, në sajë të programit të përbashkët të FGJH-së Master i shkencave në “Trajtimi automatik i dokumenteve të shkruara” me Universitetin Paris Nord, në Francë, u bë i mundur edhe anëtarësimi i UT-së në konsorciumin Aleanca e Universiteteve Evropiane i cili, në fund të vitit 2027 pritet të ketë të diplomuarit e parë, pjesë e të cilëve janë edhe studentët e FGJH-së.***

Ministrja e Arsimit dhe Sportit, Zj. Evis KUSHI përgëzoi Dekanen dhe Rektorin për arritjet e deritanishme dhe u shpreh se mbështetja e MAS-it për IAL-të në drejtim të financimit të projekteve infrastrukturore dhe zhvillimore do të vijë gjithnjë e në rritje duke u mbështetur edhe në një dialog të vazhdueshëm për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme që lidhen me arsimin e lartë.

Më poshtë foto të aktivitetit për përirimin e laboratorit për Trajtimin Automatik të Gjuhëve:



Realizimit të suksesshëm të këtij aktiviteti dhe investimeve në laboratore iu dha një zë i veçantë në publikimet e bëra nga vetë Kryeministri i Shqipërisë z. Edi RAMA dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit znj. Evis KUSHI.

link:

<https://www.facebook.com/FAKULTETIiGJUHEVEteHUAJAIUT/posts/pfbid02ywF5h7FLEMjrNVmbZaKSK9TaSkW5VPZQoxShiBRAXCbFJ7ki4WhAhq2dy3XYobkel>

link:

<https://www.facebook.com/FAKULTETIiGJUHEVEteHUAJAIUT/posts/pfbid0rYV8Gf4JtFXC1DX3RoWtRs6cbS2cUGJfb7aPHC8CsLKgYXv1ETBmsuV9xKnD3CDil>

Ky aktivitet u pasqyrua gjithashtu në web zyrtar dhe rrjetet sociale të Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

Link:

<https://www.facebook.com/FAKULTETIiGJUHEVEteHUAJAIUT/posts/pfbid0KQ9ggXjyehxPmuLASjr8hrscmUhvQPUgsaRCs47z84CpVPFYxZTG5o6USUMvChjWI>